

NDIKIMI I QËNDRUESHMËRISË SË SITUATËS MAKROEKONOMIKE NË NIVELIN E KREDIVE ME PROBLEME

Dr. Evelina Çeliku dhe Dr. Erjon Luçi¹
Departamenti i Kërkimeve

Abstrakt

Në këtë punim jemi përpjekur të analizojmë lidhjen që ekziston midis situatës makroekonomike dhe disa faktorëve të tjerë dhe kredive me probleme në vendet e tranzicionit dhe në rastin e Shqipërisë. Nga kjo analizë del se efekti i situatës makroekonomike luan një rol të rëndësishëm në Shqipëri për nivelin e kredive me probleme. Ndërkohë që eksperiencat e vendeve në tranzicion sugjerojnë se përmirësimi i ligjit është një faktor tjetër i rëndësishëm në reduktimin e kredive me probleme.

DHJETOR 2003

¹ Përkëputjet e shprehura në këtë material janë ato të autorëve dhe jo domosdoshmërisht ato të Bankës së Shqipërisë. Do të donim të falenderonim Aida Deliu dhe Ermira Tepelenën për ndihmën e tyre në përgatitjen e këtij artikulli. Çdo koment apo sugjerim është i mirëpritur.

1. Hyrje

Kreditë me probleme kanë qenë një ndër pengesat më serioze me të cilin u ndeshën bankat në vendet në tranzicion. Megjithëse, me kalimin e kohës ky problem duket të ketë ardhur në rënie, kreditë me probleme vazhdojnë të jenë të pranishme në shumë vende të tranzicionit. Nëse në periudhën e parë të tranzicionit shkaqet e kredive me probleme gjendeshin kryesisht në ineficiencën e ndërmarrjeve dhe të bankave shtetërore, tani vëmendja është përqendruar më shumë në faktorët e ambientit mikro dhe makroekonomik në të cilin operojnë bankat. Në këtë material jemi përpjekur të analizojmë pikërisht lidhjen që ekziston midis situatës makroekonomike dhe kredive me probleme në vendet në tranzicion dhe në Shqipëri. Nga kjo analizë del se efekti i situatës makroekonomike luan një rol të rëndësishëm në nivelin e kredive me probleme si në vendet në tranzicion ashtu dhe në Shqipëri. Materiali do të fokusohet në dy akse kryesore. Në një hap të parë, do të përpiqemi të japim konsideratat tona në lidhje me ecurinë e kredive me probleme dhe të disa momenteve që kanë shkaktuar ndryshimin e tendencës së ecurisë së këtyre të fundit. Pas këtij vështrimi historik, do të analizojmë lidhjet e mundshme ndërmjet disa treguesve makroekonomikë dhe cilësisë së sistemit bankar. Kjo e fundit është sintetizuar në indikatorë që përdoren sot më shumë për këtë qëllim, konkretisht, bëhet fjalë për raportin e totalit të kredive me probleme ndaj totalit të tepricës së kredive ose edhe ndaj totalit të aktiveve.

2. Kreditë me probleme dhe procesi i tranzicionit

Liberalizimi i ekonomive të centralizuara dhe shkrirja e tregjeve të *Comecon*, çoi në ndryshime të mëdha të çmimeve relative të të mirave dhe të shërbimeve, dhe në një ulje të konsiderueshme të aktivitetit të tregtisë së jashtme për shumicën e vendeve të Evropës Qendrore, Juglindore dhe ish-vendeve të Bashkimit Sovietik. Në këtë ambient të ri, ndërmarrjeve shtetërore që ishin jorentabël që përpara fillimit të tranzicionit iu shtuan edhe shumë të tjera, të cilat për shkakun e mësipërm, reflektuan bilance me rezultat ekonomik negativ. Nga ana tjetër, jo vetëm situata e vështirë financiare, por edhe mungesa e detyrimit për të plotësuar planin e shtetit si edhe e motivit të ri që i përshtatej ekonomisë së tregut, çuan në një rënie drastike të prodhimit. Turrja e prodhimit u shkaktua edhe për efekt të marrëdhënieve zinxhir të prodhimit të ndërmarrjeve shtetërore. Kështu, edhe ato ndërmarrje që u favorizuan nga ndryshimi i çmimeve relative u përballën me mungesa të theksuara lëndësh të para dhe, për rrjedhojë, mundësitë e tyre për të mbetur rentabël ishin të pakta. Për pasojë, prodhimi në ekonominë të tranzicionit në tërësi ra ndjeshëm.

Shumë prej ndërmarrjeve shtetërore humbën aftësitë paguese. Disa prej tyre akoma mund të mbulonin kostot operative, por nuk mund të paguanin shpenzimet e interesave të huave të tyre (Dittus, 1994a). Shumica e tyre mund të mbijetonin vetëm me anë të ndihmës së qeverisë (duke mundësuar pagesat për pagat e punëtorëve). Kjo situatë u përçua në mënyrë të shpejtë dhe të pashmangshme edhe në pozicionin e aktiveve të bankave tregtare shtetërore. Nga njëra anë ato trashëgonin një numër të madh kredive me probleme nga sistemi i kaluar dhe nga ana tjetër, situata e tyre u rëndua më shumë për shkak të rritjes së mëtejshme të numrit të ndërmarrjeve shtetërore me paaftësi paguese. Problemet e bankave shtetërore u thelluan më tej duke

qenë se shteti nuk i ndërpreu menjëherë linjat e kredive të ndërmarrjeve “të sëmura” shtetërore, gjë që e thelloi problemin e kredive të pakthyer të bankave shtetërore. Në këtë mënyrë, pafhtësia paguese e ndërmarrjeve shtetërore u konvertua, gjithashtu, në pafhtësi paguese të bankave shtetërore². Një burim tjetër i rëndësishëm i rritjes së kredive me probleme ishte mungesa e përvojës bankare në kushtet e një ekonomie tregu. Po kështu, zbehja e vlerave sociale, nxiti korrupsionin dhe aktivitete të ndryshme kriminale, të kanalizuar nëpërmjet sistemit bankar.

Madhësia e kredive me probleme nuk u reflektua në bilancet e bankave shtetërore në fillim të tranzicionit për shkak të dobësive dhe të pasaktësive në sistemin e kontabilitetit (Dittus, 1994a). Futja e praktikave moderne të kontabilitetit e bazuar në vlerat e tregut të aktiveve të bankave, nxori në pah rëndësinë e problemit të kredive të pakthyer. Raporti i kredive me probleme ndaj totalit të kredive u rrit ndjeshëm nga viti 1992 në vitin 1995, në shumë raste mbi 30 për qind.

Qeverive në vendet në tranzicion, të gjendura përballë situatave të vështira, u duhej të gjenin një zgjidhje për kreditë me probleme për disa arsye:

- së pari, një pjesë e madhe e kredive me probleme u gjeneruan gjatë periudhës së ekonomisë së planit si dhe inercisë së periudhës së linjave të kredisë së qeverisë gjatë fazës së hershme të tranzicionit. Prandaj, për atë pjesë të huave me probleme të shkaktuara nga inefficienca e shtetit në periudhën e mëparshme, bankat shtetërore nuk mund të bëhen përgjegjëse;
- së dyti, edhe sikur bankat shtetërore të lireshin vetëm me atë pjesë të kredive me probleme të krijuara nga inefficienca e tyre, do të ishte shumë e vështirë të privatizoheshin bashkë me kreditë e trashëguara me probleme;
- së treti, masa e madhe e kredive me probleme i la bankat shtetërore me fonde të pamjaftueshme për të investuar. Kështu që ndikimi i mundshëm i tyre në zhvillimin ekonomik u dobësua. Nga ana tjetër, ndërsa bankat duhet t’iu paguanin interes depozitorëve, pasja e kredive me probleme që nuk sillnin interes, bënte që ato të pësonin humbje të vazhdueshme, duke përkeqësuar më tej vlerën e tyre neto;
- së fundi, bankat e lëna me shumë kredi me probleme kanë probabilitet më të lartë falimentimi (Gorton dhe Winton, 1998) sepse, pavarësisht nga origjina e tyre ato mbartin kosto të vazhdueshme për bankat. Nëse bankat shtetërore lihen me kredi me probleme sektori bankar mund të humbasë besimin e depozituesve që mund të përshkallëzohet në një krizë bankare.

Pastrimi nga kreditë e trashëguara me probleme është pa dyshim një aspekt i rëndësishëm i procesit të ristrukturimit të bankave shtetërore. Megjithatë, transformimi i bankave shtetërore në ndërmjetësues eficientë financiarë, kërkon përpjekje të mëtejshme për të përmirësuar administrimin e tyre, dhe për të zhvilluar shumë aftësi të tjera bankare si analizimi dhe administrimi i rrezikut që karakterizon aktivitetin kredidhënës. Për sa kohë që nuk përmirësohen administrimi i burimeve të bankave shtetërore dhe aftësitë e punonjësve të tyre, ekziston një mundësi e madhe që

² Bankat në ish-vendet e BS dhe në ish-vendet e Jugosllavisë u përballën dhe me probleme serioze likuiditeti duke qenë se aktivet valutore të tyre u bllokuan respektivisht në Moskë dhe në Bankën Kombëtare të Jugosllavisë (Hansson dhe Tombak, 1999; Barisitz, 2002).

edhe pas rikapitalizimit të këtyre bankave, ato do të akumulojnë kredi të reja me probleme në të ardhmen. Rikapitalizimet e përsëritura, nga ana tjetër, mund të çojnë në krijimin e një sjelljeje që në literaturë njihet me emrin “*moral i rrezikshëm*” (moral hazard). Në këtë rast, duke qenë se shteti gjithmonë i shpëton bankat shtetërore, ato nuk marrin fare parasysh performancën e huave të reja. Kështu që, rikapitalizimet e përsëritura mund të rrisin më tej koston e ristrukturimit të bankave shtetërore. Për këtë arsye, shumë autorë (Begg dhe Portes, 1993; Buch, 1996; Meyendorff dhe Snyder, 1997) mbështesin idenë se rikapitalizimi i bankave shtetërore duhet të bëhet njëherë e përgjithmonë dhe duhet të ndiqet shumë shpejt nga privatizimi i tyre dhe forcimi i kuadrit rregullator për të shmangur krijimin e kredive të reja me probleme. Gjithashtu një burim i rëndësishëm i kredive të reja me probleme jo vetëm nga ana e bankave shtetërore mund të jenë dhe faktorë të tjerë si situata jo e favorshme makroekonomike apo ajo ligjore të cilat do t’i analizohen në mënyrë më të detajuar më poshtë.

Box : Eksperiencia e vendeve në tranzicion.

Eksperiencia e ekonomive në tranzicion për zgjidhjen e problemit të kredive të këqija ka qenë disi e ndryshme. Megjithatë, ka patur edhe disa ngjashmëri. Siç mund të shihet, asnjë nga vendet në tranzicion nuk ka patur një eliminim të përnjëhershëm të kredive me probleme. Rikapitalizimet e përsëritura mund të kenë qenë një prej arsyeve të shfaqes së kredive të reja me probleme. Shumë vende të Evropës Qendrore u munduan t’ia adresojnë problemin e kredive të pakthyera një faze më të hershme të tranzicionit. Por, pastrimi fillestar i bankave shtetërore ishte i pjeshëm dhe u pasua shumë shpejt nga krijimi i huave të reja me probleme. Më vonë këto vende, sidomos Polonia, u përpoqën të përfshinin bankat në procesin e ristrukturimit të ndërmarrjeve shtetërore, e cila përveç objektivave të tjerë kishte si qëllim dhe zgjidhjen e problemit të kredive të pakthyera. Por, siç u përmend më sipër një metodë e tillë nuk rezultoi shumë e efektshme. Në vendet e Evropës Juglindore, ashtu si në vendet e Evropës Qendrore, rikapitalizimi i bankave shtetërore me bono thesari dhe kalimi i kredive të pakthyera në “bankat spital” ka qenë një eksperiencë e ngjashme. Por, në dallim nga vendet e Evropës Qendrore, vendet e Evropës Juglindore nuk aplikuan skema të komplikuar për të zgjidhur problemin e kredive të pakthyera. Një rast i veçantë ishte Kroacia, ku qeveria nuk rikapitalizoi direkt bankat, por ndërmarrjet, duke u krijuar mundësi që të kthenin kreditë e marra.

Një pastrim total i bankave individuale shtetërore në shumë vende të Evropës Qendrore dhe Juglindore ishte i pashmangshëm përpara privatizimit të tyre. Asnjë investitor, sidomos i huaj, nuk do të ishte i gatshëm të blinte banka shtetërore me aktive të dyshimta. Pastrimi i paraprivatizimit, përveç kredive të pakthyera të vjetra përfshinte edhe ato të reja. Këto të fundit, në njëfarë kuptimi përbënin një kosto që lidhej me vonesat në procesin e privatizimit të bankave shtetërore.

Eksperiencia e vendeve të Balltikut ka qenë e ngjashme me atë të vendeve të Evropës Juglindore, përveç faktit që, ato u përballuan edhe me problemin e aktiveve të ngrira në Moskë ashtu si në vendet e tjera të ish-Bashkimit Sovietik. Eksperiencia e vendeve të ish-Bashkimit Sovietik, në shumë aspekte, ndryshon shumë nga ajo e vendeve të Evropës Qendrore dhe Juglindore. Periudha e tejzgjatur e hiperinflacionit në këto vende reduktoi deri-diku rëndësinë e problemit të kredive të vjetra të pakthyera. Gjithashtu, privatizimi i hershëm i bankave shtetërore nëpërmjet transferimit të pronësisë tek punonjësit dhe administratorët, pa qenë nevoja e ndonjë ristrukturimi të thellë, e hoqi presionin e zgjidhjes së problemit të huave me probleme nga qeveria.

Megjithatë, menjëherë sapo inflacioni u vu nën kontroll, problemet e aktiveve të shumë bankave u shfaqën qartë dhe disa kriza bankare pasuan. Duke mos patur fonde të mjaftueshme për rikapitalizimin e plotë të bankave, qeveritë e shumë vendeve të ish-Bashkimit Sovietik vendosën që të likuidonin shumicën e bankave në vështirësi në kurriz të depozituesve, ose rishtetëzuan disa banka private si në Bjellorusi apo në Turkmenistan.

3. Shkaqet e kredive me probleme në vendet në tranzicion

Në këtë seksion jemi munduar të identifikojmë disa nga shkaqet e kredive me probleme në vendet në tranzicion. Siç u diskutua dhe më sipër një nga arsyet për akumulimin e kredive të reja me probleme ishte administrimi i dorëlëshuar që karakterizon bankat shtetërore. Në rast se kjo hipotezë është e vërtetë atëherë duhet të presim që masa e kredive me probleme të jetë ndikuar nga raporti i aktiveve të bankave shtetërore në totalin e aktiveve të sistemit bankar. Këtë hipotezë e quajmë dhe hipoteza “*e moralit të rrezikshëm*”. Sipas Berger dhe Young (1997), ky është rasti kur një palë merr përsipër një rrezik të tepruar, ndërkohë që një palë tjetër mban një pjesë të rrezikut. Në rastin tonë, duke qenë se qeveria mban gati të gjithë rrezikun, hapësira e një sjelljeje të moralit të rrezikshëm nga ana e bankave shtetërore për të marrë një rrezik të tepruar dhe për të gjeneruar kredi me probleme është e lartë. Hipoteza e parë alternative është ajo e “*menaxhimit të keq*”. Në këtë rast, kreditë me probleme kanë ardhur si pasojë e mungesës së aftësive dhe të njohurive në administrimin e rrezikut. Në rastin e kësaj hipoteze duhet të presim që rritja e pjesëmarrjes së bankave të huaja të ndikojë në pakësimin e kredive me probleme, duke supozuar se ato duhet të sjellin praktika më të mira në administrim, përfshi këtu aftësi më të mira vlerësimi dhe monitorimi të kredive.

Një hipotezë tjetër alternative është ajo e “*shansit të keq*”. Sipas kësaj hipoteze një arsye e rëndësishme e kredive me probleme mund të mbështetet në faktorë të jashtëm të paparashikueshëm prej bankave. Një faktor i tillë mund të jetë stabiliteti makroekonomik. Një ndryshueshmëri e lartë e kushteve makroekonomike mund ta dëmtojë aktivitetin e shumë bizneseve duke vënë në vështirësi aftësinë e tyre për të respektuar afatet e kthimit të kredisë. Si *proxy* për stabilitetin makroekonomik, kemi përdorur numrin e viteve me inflacion nën 30 për qind. Një faktor tjetër i jashtëm i rëndësishëm është kuadri ligjor. Në qoftë se ligjet që mbrojnë të drejtat e kredidhënësve janë të paqarta apo nuk zbatohen me rigorozitet, atëherë duhet të presim një rritje të huave të pakthyera “me qëllim” duke qenë se kredimarrësit mund “t’ia hedhin pa problem”. Si indikator të cilësisë së ligjeve kemi përdorur Indeksin e Efektivitetit të Ligjeve të BERZH-it. Ndërkohë që si tregues të zbatueshmërisë së ligjeve kemi përdorur Indeksin e Masës së Ligjeve dhe Indeksin e Rregullit të Ligjit të Kaufman. Së fundi, duke qenë se hipotezat e mësipërme i referohen huave të reja me probleme, kemi përfshirë gjithashtu, edhe kushtet fillestare të vendeve në tranzicion (të llogaritur nga De Melo etj., 1997), për të kontrolluar për atë pjesë të kredive me probleme të trashëguara nga lidhjet me ndërmarrjet shtetërore, të njohura edhe si “problemi i huave stok”.

Për të testuar hipotezat e mësipërme kemi përdorur të dhëna nga 25 vende në tranzicion për periudhën 1995-2000. Modeli i përdorur në këtë është i formës:

$$Kredi.prob_{it} = \alpha + \sum_{j=1}^n \delta_j X_{jit} + \sum_{k=1}^m \gamma_k D_{ki} + \sum_{y=1}^l \lambda_y D_{yt} + \mu_i + \nu_{it}$$

ku: X_{ijt} janë variablat shpjgues, D_k janë variablat cilësorë për nëngrupet e vendeve në tranzicion, D_y janë variablat cilësorë për vitet. Rezultatet e tabelës 1, duket se mbështesin hipotezën e “moralit të rrezikshëm”, duke qenë se raporti i aktiveve të bankave shtetërore ndaj totalit të aktiveve ka një efekt të rëndësishëm pozitiv mbi kreditë me probleme në të gjitha regresionet. Variabli i bankave të huaja nuk ka ndonjë efekt të rëndësishëm mbi kreditë me probleme. Kjo mund të nënkuptojë faktin se mangësitë e administrimit nuk kanë luajtur ndonjë rol të rëndësishëm në krijimin e kredive me probleme. Megjithatë, duhet të kemi parasysh se përveç administrimit dorëlëshuar bankat shtetërore janë karakterizuar edhe nga praktika të dobëta administrimi. Kjo do të thotë se raporti i aktiveve të bankave shtetërore ndaj totalit të aktiveve të sistemit mund të mbështesë pjesërisht dhe hipotezën e “menaxhimit të keq”.

Për sa i përket faktorëve të jashtëm, rezultatet sugjerojnë se as stabiliteti makroekonomik (Regresi 1) dhe as cilësia e ligjeve (Regresi 2) nuk kanë kontribuar në reduktimin e huave me probleme. Në anën tjetër, të dyja indekset e zbatimit të ligjeve kanë një ndikim të rëndësishëm negativ mbi kreditë me probleme (Regresi 3, 4).

Tabelë 1: Rezultatet e kredive me probleme në vendet në tranzicion.

Variabli i varur	Kreditë me probleme				
	1995-2000	1997-2000	1997-2000	1998 & 2000	1995-2000
Variablat e pavarur	(1)	(2)	(3)	(4)	(5)
Kushtet fillestare	0.207 *** (2.910)	0.255 *** (4.830)	0.277 *** (6.160)	0.472 *** (21.790)	0.193 *** (2.950)
Stabiliteti makroekonomik	-0.008 (-1.060)				
Plotësia e ligjit		-0.003 (-0.490)			
Efektiviteti i ligjit			-0.015 * (-1.930)		
Forca e ligjit				-0.112 *** (-8.580)	
Bankat e huaja					0.019 (0.340)
Bankat shtetërore	0.001 ** (2.590)	0.002 *** (8.980)	0.003 *** (10.320)	0.002 *** (14.820)	0.001 *** (3.040)
Evropa-Juglindore	0.121 ** (2.440)	0.149 *** (3.510)	0.202 *** (6.690)	0.191 *** (9.110)	0.142 *** (3.130)
Vendet e Balltikut	0.314 ** (2.470)	0.395 *** (3.880)	0.451 *** (5.430)	0.721 *** (17.710)	0.319 *** (2.670)
CIS	0.420 ** (2.590)	0.502 *** (3.970)	0.569 *** (5.230)	0.894 *** (17.720)	0.427 *** (2.790)
Viti 96	-0.022 (-1.630)				-0.028 ** (-2.100)
Viti 97	-0.041 ** (-2.290)				-0.058 *** (-3.330)
Viti 98	-0.035 (-1.570)	0.011 * (1.930)	0.015 * (2.090)		-0.058 *** (-2.970)
Viti 99	-0.033 (-1.210)	0.000 (-0.010)	0.008 (1.140)		-0.068 *** (-3.270)
Viti 00	-0.046 (-1.340)	-0.007 (-0.770)	-0.011 (-1.390)	-0.025 *** (-14.130)	-0.091 *** (-4.260)
Konstante	-0.071 (-0.740)	-0.209 *** (-2.640)	-0.231 *** (-3.110)	-0.425 *** (-12.760)	-0.086 *** (-0.930)

R ²	0.313	0.416	0.461	0.459	0.317
LL	200.8	167.0	159.0	116.5	194.1
Wald chi-sq	149.0 ***	152.7 ***	331.9 ***	267442.1 ***	87.9 ***
Numri i vrojtimeve	137	89	89	42	135

Në bazë të rezultateve të mësipërme, burimi kryesor i kredive me probleme në vendet në tranzicion duket të jetë sjellja e “moralit të rrezikshëm” si nga ana e bankave shtetërore ashtu dhe nga ana e huamarrësve. Në rastin e parë, një sjellje e tillë ka ardhur si pasojë e pamundësisë dhe e jovullnetit të shtetit për të forcuar administrimin e burimeve të këtyre bankave, gjë e cila i hap rrugën korrupsionit në dhënien e kredive. Në rastin e huamarrësve, sjellja e moralit të rrezikshëm në moskthimin e huave nxitet nga dobësitë e zbatimit të ligjeve që mbrojnë të drejtat e investitorëve.

4. Kreditë me probleme në Shqipëri


Eksperiencia shqiptare e kredive me probleme, ashtu siç doli edhe në atë të pjesës më të madhe të vendeve të tranzicionit, ka treguar se, mangësitë e aftësive në vlerësimin e kredive së bashku me administrimin dorëlëshuar të bankave shtetërore kanë kontribuar në krijimin e një mase të madhe të kredive me probleme. Shihet nga tabela 2, se në vitin 1999, rreth 82 për qind e kredive të Bankës Kombëtare Tregtare dhe rreth 85 për qind e kredive të Bankës së Kursimeve rezultonin të pakthyera. Pjesa më e madhe e këtyre kredive me probleme ishin të reja dhe i përkisnin sektorit privat (bizneseve dhe individëve), dhe një pjesë e vogël ishte si pasojë e lidhjeve të bankave shtetërore me ndërmarrjet shtetërore. Duhet përmendur se Banka e Kursimeve klasifikoi automatikisht si kredi me probleme të gjitha kreditë e marra nga bashkimi i degëve të Bankës Agrare dhe Bankës Kombëtare Tregtare në periudhën 1997-1998, duke pretenduar se ajo nuk mund të bëhej e përgjegjshme për vendimet e marra nga bankat e tjera. Duket sikur Banka e Kursimeve, pa këto degë shtesë, do të mund të kishte vazhduar të jepte kredi edhe pas vitit 1996. Megjithatë, përvoja e kaluar e bankave shtetërore, përfshi Bankën e Kursimeve, e bindi qeverinë që krijimi i kredive të reja me probleme ishte i pashmangshëm, në qoftë se bankat shtetërore do të lejoheshin, që akoma, të jepnin kredi. Kështu që mund të thuhet se ndalimi i kreditimit për Bankën e Kursimeve, nga ana e Bankës së Shqipërisë, ishte më shumë një lëvizje strategjike për të shmangur akumulimin e kredive të reja me probleme përpara privatizimit të saj.

Megjithatë, të dhënat tregojnë se nuk janë vetëm bankat shtetërore ato që kanë regjistruar kredi me probleme. Edhe bankat private dhe ato me kapital të përbashkët kanë parë një rritje të kredive të tyre me probleme. Por, në dallim nga bankat shtetërore, kreditë e pakthyera të bankave private, në shumicën e rasteve, mund të dëshmojnë për rrezikun e lartë të aktivitetit kreditues në Shqipëri, duke supozuar që këto banka karakterizohen nga një administrim më i mirë dhe aftësi më të mira për vlerësimin e kredive. Gjykohet se edhe mungesa e eksperiencës së punës në ambientin ekonomik në Shqipëri, sidomos gjatë fillimit të aktivitetit të këtyre bankave mund të ketë luajtur një rol të rëndësishëm në akumulimin e kredive të tyre me probleme.

Tabelë 2: Ecuria e kredive me probleme ndaj totalit të kredive për sistemin (në përqindje).

	Kreditë me probleme/Totali i kredive në %									
	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002
Grupi i bankave shtetërore	12.5	29.3	31.4	34.8	49.7	80.9	84.7	87.4	7.3	16.2
Grupi i bankave me kapital të përbashkët	-	-	-	12.8	11.9	8.4	20.2	35.8	18.8	21.6
Grupi i bankave private	-	-	54.2	30.2	46.6	14.5	15.3	18.1	3.1	1.8
Totali	12.5	28.6	31.3	33.3	43.6	58.9	52.7	45.7	6.9	5.6

Sidoqoftë, vlen të theksohet se pamja e serisë së kredive me probleme për sistemin bankar në Shqipëri sugjeron më shumë ekzistencën e një trendi të lehtë në rënie. Kjo konsideratë mbetet brenda kufizimit të moshës së re të saj. Grafikët 1 dhe 2, paraqesin ecurinë e treguesve të cilësisë së sistemit bankar, përkatësisht, kredi me probleme ndaj totalit të aktiveve (NPL_TA) dhe kredi me probleme ndaj totalit të tepricës së kredisë (NPL_TK).



Grafikë 1-2: Tendencat e NPL_TA dhe NPL_TK.

Shihet qartë tendenca rënëse në mënyrë të vazhdueshme e treguesit kredi me probleme/totalit të aktiveve, tendencë që pëson një rënie në formë katarakti nga tremujori i dytë i vitit 2001 në të tretin e po këtij viti. Kjo rënie “e fortë”, ka ardhur si rezultat i vendimit administrativ, të kalimit të kredive me probleme të Bankës së Kursimeve, pranë Agjencisë së Trajtimit të Kredive (ATK). Për pasojë situata ndryshoi, në mënyrë të menjëhershme, në favor të pakësimit të këtyre kredive për sistemin bankar.

Rezultatet e vlerësimit të tendencës, tregojnë që për periudhën për të cilën disponohen të dhënat, NPL_TA ka manifestuar një tendencë rënëse, që vlerësohet statistikisht e rëndësishme, sipas vlerës së testit *t-Statistics*. Pra nga një tremujor në tjetrin, vlera e raportit NPL_TA, ka rënë mesatarisht me afër 0.37 për qind.

Ndërkohë që efekti sasior i vendimit, për kalimin e kredive me probleme të Bankës së Kursimeve pranë Agjencisë së Trajtimit të Kredive (tremujori i dytë 2001), vlerësohet mesatarisht në masën 1.87 për qind, mbi tendencën e përgjithshme të NPL_TA. Në tërësi vlerësohet një regres statistikisht i rëndësishëm: me një koeficienti të korigjuar të përcaktueshmërisë prej afro 93.6 për qind.


Tabelë 3: Rezultatet e regresit për tendencën e NPL_TA (T4-2000 – T3 – 2003).

Variabli i varur	Kredi me probleme/totalin e aktiveve
Variablat e pavarur	
Konstantja	6.80 *** (26.37)
Variabli kohë (<i>Time</i>)	-0.35 *** (-14.84)
Variabli cilësor (<i>Dummy1</i>)	-1.87 *** (-4.92)
Koeficienti i përcaktueshmërisë së korigjuar	0.94
F-stat	140.2 ***
Numri i vrojtimeve	20


Duke përjashtuar periudhën e përfaqësuar nga variabli cilësor *Dummy1*³ që sugjeron dhe justifikon plotësisht mundësinë e përjashtimit të saj, tendenca e treguesit NPL_TA në kohë, është më e pastër. Vlerësohet që tendenca rënëse e treguesit NPL_TA për sistemin bankar ka qenë mjaft e lehtë.

Kjo tendencë paraqitet më me thyerje kur bëhet fjalë për treguesin e kredive me probleme ndaj totalit të tepricës së kredive (NPL_TK). Kjo thyerje fillon që nga tremujori i katërt 2000, ku raporti NPL_TK, pëson një rritje të dukshme në krahasim me periudhën pararendëse. Megjithëse për tre tremujorët vijues rritja nuk vazhdon me të njëjtat ritme, përsëri treguesi mbetet në nivele mjaft të larta. Ky fakt nxjerr në pah një përkeqësim të situatës në sistemin bankar për këtë periudhë.

Periudha nga tremujori i tretë i vitit 2001 e në vijim, karakterizohet nga rënia e theksuar, e shkaktuar nga vendimi administrativ, tashmë i shpjeguar. Ekzistenca e luhatjeve të dukshme, e bën të vështirë gjetjen e një trendi të rregullt. Për këtë arsye, copëzimi i serisë në tre seksione dhe gjetja e një tendence për secilin, është një teknikë më transparente se sa ajo e mesatarizimit të të gjitha tendencave që ndikojnë tek treguesi.



Grafik 3: Trendi i NPL_TK për periudhën T4-1998 deri T2-2000.



Grafik 4: Trendi i NPL_TK për periudhën T3-2000 deri T2-2001.

Për periudhën e parë: nga T4-1998 deri në T2-2000 duket qartë tendenca rënëse. Shenja negative e koeficientit të regresit, tregon se për këtë periudhë NPL_TK ka rënë mesatarisht nga njëri tremujor në tjetrin me rreth 0.64 për qind.


Për periudhën T3-2000 deri T2-2001, bie në sy tendenca e theksuar në rritje e raportit NPL/TK, me mesatarisht 3.05 për qind nga një tremujor në tjetrin.

³ Periudha e marrjes së vendimit për kalimin e kredive me probleme nga Banka e Kursimeve në Agjencinë e Trajtimit të Kredive.

Tabelë 4: Rezultatet e regresit për tendencën e NPL TK (T4-2000 deri T3 – 2003).

Variabli i varur	Kredi me probleme/totalit të kredive
Variablat e pavarur	
Konstantja	75.34 *** (10.06)
Variabli kohë (Time)	-4.10 *** (-7.95)
Variabli cilësor (Dummy1)	-17.62 ** (-4.28)
Koeficienti i përcaktueshmërisë i korigjuar	0.86
F-stat	34.37 ***
Numri i vrojtimeve	12

Rezultatet tregojnë që marrja e masës administrative ka pakësuar mesatarisht nga njëri tremujor në tjetrin, treguesin NPL_TK, me afro 17.6 për qind, për më tepër ky ndikim është statistikisht i rëndësishëm. Ndërkohë që edhe tendenca e përgjithshme rënëse gjatë kësaj periudhe vlerësohet të jetë afër 4.1 për qind nga njëri tremujor në tjetrin.



Grafik 5: Trendi i NPL_TK nga T4-2000 deri T3-2003.

Analiza më sipër u referohet treguesve relativë, ndërkohë që ata absolutë nuk duhen mënjeluar gjatë procesit të ekzaminimit. Shkalla e përmbyshjes së synimeve të kësaj analize, është modeste, për sa kohë që ekzistojnë disa kufizime objektive, ndër të cilat veçohen:

A) fusha në të cilën ofrohet kjo analizë, është ende e pashkelur, në kuptimin e studimeve empirike, për Shqipërinë. Kjo për faktin se përvoja paraardhëse lidhet më shumë me analizat e treguesve për nevojat e mbikëqyrjes bankare;

B) seritë kohore për treguesin e kredive me probleme datojnë në të vërtetë që nga mesi i viteve '90. Megjithëse procesi i kredidhënies kishte filluar që prej viteve 1992-1994, çështja e kredive me probleme u shfaq më hapur, për kreditë afatmesme dhe afatgjata, në momentin e maturimit të tyre, kur një pjesë e madhe e tyre rezultojnë me parregullsi në drejtim të respektimit të afateve të shlyerjes (vonesa kohore) apo në rastin më të keq të pakthyera fare. Do të ishte deri-diku e përshtatshme kryerja e analizave empirike për seri që kanë një kohëzgjatje të tillë (pra që nga, të paktën, viti 1994 e deri më sot), por ekziston edhe një kufizim tjetër i rëndësishëm, që në njëfarë mënyre ndan në mënyrë cilësore dy periudhat: deri në vitin 1997 dhe pas 1997. Ky kufizim ka të bëjë me dy momente që duhet të sqarohen:

- momenti metodologjik:** deri në vitin fund të vitit 1998, klasifikimi sipas kategorive dhe nënkategorive të kredive me probleme bëhej mbi disa kriterë

që ndryshojnë nga klasifikimet e sotme⁴. Në këtë mënyrë, vlera e tyre nuk është e krahasueshme për periudhat respektive kohore. Kjo vështirësi bëhet edhe më e evidente kur studiohen kreditë me probleme në vende të ndryshme, ku kriteret e klasifikimit janë të variueshme, e për pasojë ndërlikohet interpretimi në analizat krahasuese për kategorinë e kredive me probleme;

- b) **momenti i ndryshimit të politikës së kredidhënies:** konsiderohet si mjaft i rëndësishëm, madje më me peshë se sa ai metodologjik. Deri para vitit 1997, politika kredituese ishte bazuar më shumë mbi kritere joprofesionale. Kjo nënkupton faktin që, shpesh kreditë akordoheshin mbi kritere politike e miqësore, pa u mbështetur mbi parime që studiojnë dhe analizojnë kushtet ekonomiko-financiare të aplikuesve për kredi. Shpeshherë, këto kredi akordoheshin me kushte lehtësuese dhe të pamotivuara. Përgjithësisht ishin kreditë afatmesme dhe afatgjata që ‘kishin akses’ në këtë lloj “trafikun kredidhënës”. Në këto kushte të kreditimit rreziku i moskthimit të tyre jo vetëm që ishte potencial, por u kthye në një realitet. Goditja që iu dha ekonomisë shqiptare në fund të vitit 1996 dhe në fillim të vitit 1997, me historinë famëkeqe të firmave piramidale, krijoi dhe bëri të domosdoshme nevojën e respektimit të rregullave të lojës edhe në fushën e kredidhënies bankare. Kështu fundi i vitit 1997, duke e gjetur sistemin bankar në një ngërç të plotë, hapi faqen e një politike “të egër” kufizuese për kredidhënien, në mënyrë që të fillonte reduktimi dhe parandalimi i fenomenit të kredive me probleme. Banka të tilla të mëdha shtetërore, si Banka e Kursimeve, Banka Kombëtare Tregtare, Banka Tregtare Agrare, u kufizuan të kreditonin: ato vetëm mund të ndiqnin kreditë në proces.

Këta faktorë konsiderohen mjaft të rëndësishëm, sepse në njëfarë kuptimi, ndryshuan sjelljen e sistemit bankar kundrejt procesit të kredidhënies, duke ndikuar në përmirësimin e parametrave të cilësisë së sistemit bankar.

Megjithë këtë kufizim serioz, ‘seri me pak të dhëna’, duke filluar që nga fundi i vitit 1998 e deri më sot, është punuar për të arritur në disa përfundime që shpresojmë t’i vijjnë në ndihmë të interesuarve, studiues të fushës së ekonomisë në përgjithësi dhe atyre të sistemit bankar në veçanti.

5. Situata makroekonomike dhe treguesit e cilësisë së portofolit të kredisë: Rasti i Shqipërisë (1998 – 2003).

Matja e shkallës së ndjeshmërisë së sistemit bankar, kundrejt humbjeve të paparashikuara që mund t’i shkaktohen atij nga procesi i kredishlyerjes, është mjaft e vështirë. Megjithatë, janë bërë përpjekje të ndërtimit të modeleve empirike, që vlerësojnë masën e ndikimit të faktorëve të ndryshëm makroekonomikë mbi tregues të tillë që flasin për cilësinë e sistemit bankar, si për shembull, mbi raportin e kredive me probleme mbi totalin e aktiveve.

⁴ Me zbatimin e “Manualit të kontabilitetit bankar”, të vitit 1998, koncepti i kredive me probleme fitoi një kuptim më të detajuar, për pasojë edhe një klasifikim të ri. Në këtë manual, koncepti “Kredi me probleme”, përfshin grupet e kredive “Nën standard”, “Të dyshimta”, “Të humbura”.

Siç dihet, kategoria e kredive me probleme shkaktohet nga huamarrësit që nuk i kthejnë apo që i kthejnë ato me vonesë. Ata u përkasin grupeve të ndryshme ekonomike që zhvillojnë aktivitetin e tyre mikroekonomik brenda ambientit makroekonomik në një kohë dhe në një hapësirë të caktuar. Pra, sjellja e tyre varet dhe ndikohet nga ecuria e treguesve më themelorë që karakterizojnë zhvillimin makro të një vendi. Nëse tregues të tij shfaqin ecuri jo të favorshme për huamarrësit, kjo do të ndikonte në një mënyrë apo në një tjetër edhe mbi shkallën e kthyeshmërisë së kredive dhe kjo e fundit mbi cilësinë e sistemit bankar në tërësi.

Modeli i sugjeruar merr në konsideratë një lidhje deri – diku komplekse ndërmjet variablit që shpreh cilësinë e portofolit të kredisë në sistemin bankar dhe variablave të tjerë, që gjykohet se janë përcaktues në ecurinë e tij.

Forma e modelit është si më poshtë:

$$NPL/TA = \alpha + \beta*i + \delta*p + \delta*\Delta PBB + \epsilon.$$

Variablat e përdorur janë me frekuencë tremujore.

Më konkretisht ekuacioni shpreh lidhjen midis variablit endogjen, NPL_TA, dhe variablave të tjerë ekzogjenë që janë:

- normat nominale të interesit të kredive: i ;
- norma e inflacionit: p ;
- ndryshimi tremujor në përqindje të PBB-së: ΔPBB ;
- termi i rastit apo i gabimit: ϵ ;
- koeficientët pranë variablave të pavarur, janë koeficientët e regresit që shprehin në mënyrë respektive rritjen apo rënien mesatare (kjo varet nga shenja që ata marrin) të NPL_TA ndaj çdo rritje me një njësi të secilit variabël endogjen;
- analiza nënkupton që kur merret një variabël në shqyrtim të tjerët nuk ndryshojnë.

Modeli i përshkruar më sipër, në krahun e djathtë të barazimit shpreh kombinimin e treguesve kryesorë makroekonomikë: pra në njëfarë mënyre pasqyron me anë të treguesve situatën e përgjithshme ekonomike në të cilën zhvillojnë aktivitetin e tyre edhe huamarrësit. Krahu i majtë i tij, jep vlerën që merr treguesi i NPL_TA, cilësia e sistemit bankar apo një lloj probabiliteti i moskthyeshmërisë së kredive të marra, i cili kushtëzohet, në rastin konkret nga ambienti makroekonomik. Kjo do të thotë që vlerat e treguesve makro në një kohë të caktuar përcaktojnë këtë raport.

Rezultatet e modelit me të dhënat e disponueshme paraqiten në tabelën 5.

Tabelë 5: Rezultatet e regresit për modelin.

Variabli i varur	Kredi me probleme/totalin e aktiveve
Variablat e pavarur	
Log (GDP(-1))	-9.80 ** (-2.80)
Log(Int_kredi(-2))	5.59 *** (6.29)
Dummy 1	-1.26 ** (-2.25)
Log (ICK(-3))	15.43 * (2.25)
Koeficienti i përcaktueshmërisë i korigjuar	0.86
D-W-stat	1.99
F-stat	34.51 ***
Numri i vrojtimeve	20

Këto rezultate mund të konkludohet se:

Shenjat e koeficientëve të regresit përputhen me logjikën ekonomike që në rastin konkret do të thotë që:

- një rritje e PBB-së në periudhën (tremujorin) 't' ndikon në uljen e mundësive për moskthimin e kredisë në (t+1), pra pas një tremujori;
- një rritje e normave të interesit të kredihënies në peridhën 't', ndikon në rritjen e mundësisë për moskthim kredie në periudhën t+2, pra pas dy tremujorëve;
- një rritje e indeksit të përgjithshëm të çmimeve të konsumit në peridhën 't', ndikon në rritjen e mundësisë për moskthim kredie në periudhën t+3, tre tremujorë më vonë;
- nga seksioni paraardhës justifikua praninë e variablit cilësor në model.

6. Konkluzione

Në këtë material është bërë një përpjekje për të zbuluar disa nga faktorët që ndikojnë në krijimin e kredive me probleme në vendet në tranzicion dhe në rastin e veçantë të Shqipërisë. Rezultatet e analizës sonë tregojnë se problemet e kuadrit ligjor dhe zbatimi rigoroz të tij janë faktorë të rëndësishëm që shpjegojnë vëllimin e kredive me probleme në vendet në tranzicion. Gjithashtu, situata makroekonomike përbën një faktor tjetër të rëndësishëm në akumulimin e kredive të reja me probleme. Jo pa qëllim në analizën më sipër nuk i dhamë rëndësi të veçantë, vlerave të parametrave pranë variablave, jo pse ata nuk janë të tillë, por për faktin se të dhënat që disponojmë, konkretisht, gjatësia e serisë së kredive me probleme, është ende e ulët, për të nxjerrë konkluzione sasiore dhe statistikisht të mbështetura, për më tepër afatgjata.

Sidoqoftë, një konkluzion cilësor dhe jo i rastit verifikohet: gjatë periudhës 1998-2003 në Shqipëri, ambienti makroekonomik ka mbështetur zhvillimet në sistemin bankar, konkretisht në atë të reduktimit të kredive me probleme.

Pavarësisht shumë faktorëve të tjerë që ndikojnë tek treguesit e cilësisë së portofolit të kredisë, faktorët makroekonomikë kanë luajtur një rol të rëndësishëm.

Ndërkohë, konsolidimi i lidhjeve dhe i rezultateve sasiore, pa dyshim që do të mbështesë në të ardhmen edhe analizat dhe kërkimet në fushën e mbikëqyrjes

bankare. Në këtë aspekt do të theksohej fakti se krahas treguesve relativë që janë aplikuar në analizat e mësipërme, nuk duhen anashkaluar edhe ata absolutë. Nga ana tjetër, problemi i ndryshimeve metodologjike, bën që seritë të kenë shkëputje dhe kjo nxjerr nevojën e rishikimit apo përshtatjes së tyre me metodologjinë aktuale, në mënyrë që historia e treguesve të jetë sa më e gjatë. Po kështu, problemi i klasifikimit të kredive me probleme si sistem bankar, kërkon që paraprakisht bankat e nivelit të dytë të zbatojnë një kriter krejtësisht të unifikuar për evidentimin e tyre. Kjo për faktin se, nga ana e mbikëqyrjes bankare vërehen edhe shmangie në zbatueshmërinë rigoroze që duhet të ketë rregulli për klasifikimin e kredive me probleme.

Referencat

- Ábel, I., dhe Bonin, J. P. (1992) "Stabilisation dhe Convertibility in the Transition: The legacies of the twin deficits," *Structural Changes dhe Economic Dynamics*, Vol. 3, Nr. 1, ff. 37-51.
- Ábel, I., Siklos, P. L., dhe Szekely, I. P. (1998) *Money dhe Finance in the Transition to a Market Economy*, Elgar, Cheltenham.
- Barisitz, S. (2000a) "The development of banking sectors in Russia, Ukraine, Belarus dhe Kazakhstan since independence," *Focus on Transition*, Nr. 1 (Oesterreichische Nationalbank), ff. 67-99.
- Barisitz, S. (2000b) "The development of the Croatian banking sector since independence," *Focus on Transition*, Nr. 2 (Oesterreichische Nationalbank), ff. 96-122.
- Barisitz, S. (2001) "The development of the Romanian dhe Bulgarian banking sectors since 1990," *Focus on Transition*, Nr. 1 (Oesterreichische Nationalbank), ff. 79-118.
- Begg, D., dhe Portes R. (1993) "Enterprise Debt dhe Financial Restructuring in Central dhe Eastern Europe" *European Economic Review*, Vol. 37, ff. 396-407.
- Berger, A. N., dhe De Young, R. (1997) "Problem Loans dhe Cost Efficiency in Commercial Banks," *Journal of Banking dhe Finance*, Vol. 21, ff. 849-870.
- Blaschke, W. Jones, M. T., Majnoni, G. dhe Peria, S. M. (2001) "Stress Testing of Financial Systems: An Overview of Issues, Methodologies, and FSAP Experiences" IMF Working Paper, Nr. WP/01/88.
- Bonin, J. P., dhe Leven, B. (2000) "Can banks promote enterprise restructuring: Evidence from a Polish bank's experience," William Davidson Institute, Working Paper Nr. 294.
- Bonin, J. P., dhe Mitchell, J. (1992) "Creating Efficient Banks During the Transition: Do Bad Loans Lead to Bad Policy?" Paper presented at the American Economics Association Meetings, Anaheim, CA, January 1993.
- Bonin, J. P., dhe Wachtel, P. (1999b) "Toward market-oriented banking in economies in transition" in Blejer, M. I., dhe Škreb, M. eds. *Financial sector transformation: lessons from the economies in transition*, Cambridge University Press, Cambridge.
- Buch, C. M. (1996) *Creating efficient banking systems: Theory dhe evidence from Eastern Europe*, Kieler Studien, Tübingen: Mohr (Siebeck)
- De Melo, M., Denzier, C., Gelb, A., dhe Tenev, S. (1997) "Circumstance dhe choice: The role of initial conditions dhe policies in transition economies," World Bank, Policy Research Working Paper Nr. 1866.
- Dittus, P. (1994a) "Bank Reform dhe Behaviour in Central Europe" *Journal of Comparative Economics*, Vol. 19, Nr. 3, ff. 335-361.
- EBRD (1999) *Transition Report, 1999*, London 1999.
- EBRD (2001) *Transition Report, 2001*, London 2001.
- Gorton, G., dhe Winton, A. (1998) "Banking in transition economies: Does efficiency require instability?," *Journal of Money Credit dhe Banking*, Vol. 30, Nr. 3, ff. 621-651.
- Gray, C. W., dhe Holle, A. (1997) "Bank led restructuring in Poldhe (II): Bankruptcy dhe its alternatives," *Economics of Transition*, Vol. 5, Nr. 1, ff. 25-44.

- Gurgendize, L. (1993) "Securisation of Non-Performing Loans in Transitional Economies," Institute for the East-West Studies, New York, mimeo.
- Hansson, A. H., dhe Tombak, T. (1999) "Banking Crises in the Baltic States: Causes, Solutions, dhe Lessons," in Blejer, M. I., dhe Skreb, M. eds., *Financial Sector Transformation: Lessons from Economies in Transition*, Cambridge University Press, Cambridge.
- Hoelscher, D. (1998) "Banking System Restructuring in Kazakhstan," IMF, Working Paper Nr. 98/96.
- IMF (1998a) "Former Yugoslav Republic of Macedonia: Recent Economic Developments," Staff Country Report Nr. 98/82
- IMF (1998b) "Kyrgyz Republic: Recent Economic Developments," Staff Country Report Nr. 98/8
- IMF (1999) "Turkmenistan: Recent Economic Developments," Staff Country Report Nr. 99/140.
- IMF (2000a) "Azerbaijan Republic: Recent Economic Development dhe Selected Issues," Staff Country Report Nr. 00/121
- IMF (2000a) "Azerbaijan Republic: Recent Economic Development dhe Selected Issues," Staff Country Report Nr. 00/121.
- IMF (2000b) "Kyrgyz Republic: Selected Issues dhe Statistical Appendix," Staff Country Report Nr. 00/131.
- Jankov, L. (2000) "Banking Sector Problems: Causes, Solutions dhe Consequences," Croatian National Bank Surveys 1, March.
- Meyendorff, A., dhe Snyder, E. A. (1997) "Transactional Structures of Bank Privatisations in Central Europe dhe Russia," *Journal of Comparative Economics*, Vol. 25, Nr. 1, ff. 5-30
- Rostowski, J. eds. (1995) *Banking Reform in Central Europe dhe the Former Soviet Union*, Central European University Press, Budapest.
- Schardax, F., dhe Reininger, T. (2001) "The Financial Sector in Five Central dhe Eastern European Countries: An Overview," *Focus on Transition*, Nr. 1 (Oesterreichische Nationalbank), ff. 30-64.
- Stiblar, F. (1999) "Bank Rehabilitation in Slovenia: With Emphasis on Nova Ljubljanska Banka," in Blejer, M. I., dhe Skreb, M. eds. *Financial Sector Transformation: Lessons from Economies in Transition*, Cambridge University Press, Cambridge.
- Székely, I. P. (1994) "Economic Transformation dhe the Reform of the Financial System in Central dhe Eastern Europe" in A. Aganbenjan dhe E. Bogomolov eds., *Economics in Changing World*, 1, Macmillan, London, ff. 260-291.
- Wijnbergen, S. van (1994) *Eastern Europe after the First Five Years*, Amsterdam University Press, Amsterdam.
- Winkler, A. (2000) "Private dhe Financial Sector Development in Transition Economies: The Case of Macedonia," *Economic Systems*, Vol. 24. Nr. 3, ff. 257-284.
- Zoli, E. (2000) "Cost dhe Effectiveness of Banking Sector Restructuring in Transition Economies," IMF, Working Paper Nr. 01/157.